

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Junikut z. Agron Kuçi**

I nderuari z. Kuçi,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7 – 12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në “Jeta në Kosovë”, ju keni premtuar:

- Asfaltimin e të gjitha rrugëve lokale;
- Furnizimin me ujë të pijshëm për 24 orë në ditë;
- Kyçjen e lagjes Gocaj në ujësjellës dhe riparimin e rrjetit kryesor në lagjen Gacaferi;
- Ndërtimin e kanalizimit të ujërave të zeza;
- Themelimin e ndërmarrjes publike për pastrimin e mbeturinave;
- Ndërtimin e qendrës për mjekësi familjare;
- Hartimin e planit rregullativ për 2 shkollat fillore dhe të mesme dhe instalimin e ngrohjes qendrore në shkollën fillore;
- Ndërtimin e trafave të reja;
- Ndërtimin e tregut të ri të gjelbër;
- Përcaktimin e zonës industriale;
- Përcaktimin e vendit për varrezat e qytetit dhe mirëmbajtjen e atyre ekzistuese;
- Ndërtimin e rrugës Junik –Gjoqaj-Bjeshkë të Nemuna;
- Mbrojtjen e pyjeve nga degradimi;
- Ndërtimin e fushës së futbollit;
- Ndërtimin e qendrës kulturore;
- Ndërtimin e pendës për ujitje dhe kanaleve për ujitje;

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)